

PROJEKT BASHKIMI

Shoqeria: "H-COMMUNICATIONS" sh.a. shoqeria Perthithese	Shoqeria: "HERMES" sh.p.k., shoqeria e Perthithur
Forma juridike: Shoqeri anonime.	Forma juridike: Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.
Selia: Rr. "Deshmoret e 4 Shkurtit", Pallati 26, Ap.40, Tirane.	Selia: Rr. "Deshmoret e 4 Shkurtit", Pallati 26, Ap.40, Tirane.
Kapitali themeltar: 165.000.000 leke.	Kapitali themeltar: 100.000 leke.
Aksione te emetuara: 16.500 cope.	Pjese te kapitalit: 100 cope.
Vlera nominale e nje aksioni: 10.000 leke.	Vlera nominale e nje pjese: 1.000 leke.
Aksionaret: 1. Vilma Nushi , zoteruese e 35 % te aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise. 2. Shoqeria "HERMES" sh.p.k. , regjistruar me Vendimin Nr.24200, date 24.07.2000, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, zoteruese e 65 % e aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise, e perfaqesuar nga Administratore Zj.Albina Mançka.	Ortaket: 1. Albina Mançka , zoteruese e 68 % te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise. 2. Vilma Nushi , zoteruese e 7.5 % te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise. 3. Minako Koçollari , zoterues e 12.5 % te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise. 4. Vançi Deti , zoterues i 6 % te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise. 5. Piro Braçe , zoterues i 6 % te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.
Drejtori ekzekutiv: Arben Seferaj.	Administratore: Albina Mançka.
Nr. Regj. Tregetar 25674, date 25.04.2001.	Nr. Regj. Tregetar 24200, date 24.07.2000.

► **Objekti i veprimtarise se shoqerise "H-COMMUNICATIONS" sh.a.:** Shoqeria eshte licensuar ne fushen e telekomunikacionit.

► **Objekti i veprimtarise se shoqerise "HERMES" sh.p.k.:** Shoqeria eshte licensuar ne fushen e telekomunikacionit.

Shoqeria "H-COMMUNICATIONS" sh.a.

dhe

Shoqeria "HERMES" sh.p.k.

Hartojne nepermjet perfaqesuesve te tyre ligjore kete projekt per bashkimin nepermjet perthithjes me permbajtjen qe vijon:

1. Drejtimi i bashkimit:

Ne kete operacion bashkimi Shoqeria "H-COMMUNICATIONS" sh.a. do te jete shoqeria perthithese e shenuar ne vijim si shoqeria perfituese e kontributeve kurse, Shoqeria "HERMES" sh.p.k. do te jete shoqeria e perthithur, e shenuar ne vijim dhe si shoqeria kontribuese.

2. Motivet dhe qellimet e bashkimit.

Perqendrimi i kapitalit, i forcave dhe mjeteve per krijimin e produkteve te reja dhe i marketingut ne funksion te rritjes te perfitueshmerise.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "H-COMMUNICATIONS" sh.a. do te perfshije veprimtarine e Shoqerise "HERMES" sh.p.k. .

Te gjitha ndryshimet do te pasqyrohen ne statutin e shoqerise perthithese "H-COMMUNICATIONS" sh.a.

3. Aktivitetet dhe pasivitetet (detyrimet) e parashikuara per tu transferuar.

Ne kuadrin e ketij operacioni bashkimi projekti i te cilit do te depozitohet ne gjykate, parashikohet qe Shoqeria "HERMES" sh.p.k. t'i transferoje Shoqerise "H-COMMUNICATIONS" sh.a. teresine e elementeve te aktivitetit dhe te pasivitetit sipas bilancit kontabel.

4. Modalitetet.

Shoqeria "H-COMMUNICATIONS" sh.a. do te jete zoteruese e kontributit te Shoqerise "HERMES" sh.p.k. ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Shoqeria "H-COMMUNICATIONS" sh.a. gezon frutet e kontributit duke filluar nga **1 Janar 2007**, me kushtin e realizimit te bashkimit ne fjale.

Perkundrajt kontributit te perfituar Shoqeria "H-COMMUNICATIONS" sh.a. si shoqeri perfituese do t'i jape ortakeve te shoqerise kontribuese "HERMES" sh.p.k. aksione te kapitalit themeltar. **Keto aksione do ti japin te drejten per dividende pas dates 1 Janar 2007.**

5. Data kontabel.

Ne aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarise te kryera prej shoqerise "HERMES" sh.p.k. nga data **1 Janar 2007** deri ne daten e realizimit te bashkimit do te konsiderohet si te kryera nga shoqeria perthithese "H-COMMUNICATIONS" sh.a. dhe regjistrimet kontabel perkatese do te merren ne librat e saj.

6. Datat e pergatitjes (hartimit) te llogarive.

Llogarite qe jane perdorur per te percaktuar kushtet financiare te bashkimit jane hartuar duke u referuar dates **31.12.2006**, si per shoqerine perthithese "H-COMMUNICATIONS" sh.a., ashtu edhe per shoqerine e perthithur "HERMES" sh.p.k. Pas kesaj date veprimet ekonomike qe do te kryhen do te pasqyrohen ne kontabilitet nga shoqeria perthithese "H-COMMUNICATIONS" sh.a..

7. Shuma e parashikuar e primit te bashkimit.

Mbajtja e primeve nuk konsiderohet e nevojshme.

8. Te drejta dhe avantazhe te vecanta.

Ky operacion bashkimi nuk do te permbaje as te drejta dhe as ndonje avantazh te vecante.

9. Baza ligjore.


Ligji Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare,,nenet 234-255, 261.

Ligji Nr.7667 dt.28.01.1993"Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare,,neni 58.

Ky projekt bashkimi hartohet e nenshkruhet me kushtin e varesise te miratimit nga asambleja e pergjithshme e seciles prej shoqerive pjesemarrese.

Tirane, me 30/11/ 2006.

Shoqeria " H-COMMUNICATIONS "sh.a.
Perfaqesuar nga Drejtori :
Arben Seferaj



Shoqeria "HERMES"sh.p.k.
Perfaqesuar nga administratore:
Albina Mancka

